



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
MINISTRI

Nr. ~~7177~~ / prot.

Tiranë, më 10/12/2019

URDHËR

Nr. 715, datë 10.12.2019

**“PËR
MIRATIMIN E FORMATIT, ÇMIMIT, KATEGORISË DHE MËNYRËS SË
EMETIMIT TË BILETAVE PËR MUZETË ME STATUS KOMBËTAR, MUZETË
QENDROR PUBLIK, MONUMENTET E KULTURËS DHE PARQET
ARKEOLOGJIKE, NË VARËSI TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE
PËR TRASHËGIMINË KULTURORE”**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 176, 233 dhe 278 të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” si dhe Relacionit shoqërues

URDHËROJ:

1. Miratimin e formatit dhe çmimit të biletave për muzetë me status kombëtar, muzetë qendror publik, monumentet e kulturës dhe parqet arkeologjike, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, përkatësisht sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Miratimin e kategorisë së biletave për muzetë me status kombëtar, muzetë qendror publik, monumentet e kulturës dhe parqet arkeologjike, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, sipas lidhjes nr. 3 bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Emetimin e biletave në muzetë me status kombëtar, muzetë qendror publikë, monumentet e kulturës dhe parqet arkeologjike, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, si më poshtë vijon:
 - a) biletat me çmim të parashtypur emetohen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, ose nga institucionet e trashëgimisë kulturore përkatëse, pranë Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë, sipas procedurave ligjore në fuqi bazuar në formatin e përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri;
 - b) biletat elektronike të shitura në sportel emetohen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, ose nga institucionet e trashëgimisë kulturore përkatëse, sipas procedurave ligjore në fuqi, bazuar në formatin e përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri;
4. Ekspozimin në një vend të dukshëm të çmimeve të miratuara të biletave për vizitorët sipas kategorive përkatëse në një vend të dukshëm pranë biletarisë së institucionit, muzeut, monumentit të kulturës apo parkut arkeologjik.
5. Për vitin 2020, një pjesë e të ardhurave që vijnë nga shitja e biletave kalojnë në fondin e emergjencave civile, duke respektuar ndarjen në përqindje, sipas parashikimeve në aktet nënligjore në fuqi mbi krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të Ministrisë së Kulturës.

6. Ngarkohen institucionet publike, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, që kanë në administrim muzetë me status kombëtar, muzetë qendror publik, monumentet e kulturës dhe parqet arkeologjike, për zbatimin e këtij urdhri.
7. Ngarkohet Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Kulturës për komunikimin e këtij urdhri.
8. Shfuqizimin e Urdhrave si më poshtë vijon:
 - Urdhri nr. 52, datë 10.02.2009 i ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve “Për miratimin e çmimit të biletave për vizitorë në muzetë kombëtarë, parqet arkeologjike dhe monumentet e kulturës”, i ndryshuar;
 - Urdhri nr. 183, datë 06.06.2012 i ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve “Për miratimin e çmimit të biletave për vizitorë në Parkun Arkeologjik Lezhë”;
 - Urdhri nr. 106, datë 21.04.2016 i ministrit të Kulturës “Për miratimin e formatit dhe çmimit të biletës së Muzeut Kombëtar të Fotografisë ‘Marubi’”, i ndryshuar;
 - Urdhri nr. 257, datë 28.07.2016 i ministrit të Kulturës “Për miratimin e formatit dhe çmimit të biletës së Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar Korçë”, i ndryshuar;
 - Urdhri nr. 151, datë 04.04.2017 i ministrit të Kulturës “Për miratimin e formatit dhe çmimit të biletës së Muzeut Kombëtar të Përgjimeve ‘Gjethi’”;
 - Urdhri nr. 582, datë 08.09.2017 i ministrit të Kulturës “Për miratimin e formatit të biletës hyrëse në Kalanë Berat”;
 - Urdhri nr. 583, datë 08.09.2017 i ministrit të Kulturës “Për miratimin e formatit të biletës hyrëse në Kalanë Gjirokastrë”;
 - Urdhri nr. 584, datë 08.09.2017 i ministrit të Kulturës “Për miratimin e formatit të biletës hyrëse në Muzeun Kombëtar Ikonografik ‘Onufri’, Berat”;
 - Urdhri nr. 585, datë 08.09.2017 i ministrit të Kulturës “Për miratimin e formatit të biletës hyrëse në Kalanë Shkodër”;
 - Urdhri nr. 586, datë 08.09.2017 i ministrit të Kulturës “Për miratimin e formatit të biletës hyrëse në Muzeun Kombëtar ‘Gjergj Kastrioti Skënderbeu’, Krujë”;
 - Urdhri nr. 842, datë 29.12.2017 i ministrit të Kulturës “Për miratimin e çmimit të biletës në Muzeun Arkeologjik dhe në Amfiteatrin Durrës”;
 - Urdhri nr. 843, datë 29.12.2017 i ministrit të Kulturës “Për miratimin e çmimit të biletës në Parkun Kombëtar ‘Butrint’”, i ndryshuar;
 - Urdhri nr. 609, datë 07.09.2018 i ministrit të Kulturës “Për miratimin e formatit të biletës hyrëse në Muzeun Kombëtar të Fotografisë ‘Marubi’, Shkodër”;
 - Urdhri nr. 495, datë 30.08.2019 i ministrit të Kulturës “Për miratimin e formatit të biletës ‘Audio-Guidë’ të Muzeut Kombëtar Ikonografik ‘Onufri’, Berat”.

Ky urdhër hyn në fuqi në datën 1 Janar 2020.

MINISTRI


ELVA MARGARITI



LIDHJE NR.1

Formati biletës

Bileta manuale



1. Bileta prodhohet nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë.
2. Përmasat e biletës manuale 9 cm x 5.5cm.
3. Bileta përmban logon e Ministrisë së Kulturës dhe logon e institucionit administrues.
4. Logo e UNESCO-s vendoset nëse siti ndodhet brenda pasurisë kulturore botërore.
5. Imazhi përfaqësues i institucionit vendoset në pjesën e prapme të biletës.

Bileta elektronike

5.37 cm

EMRI I INSTITUCIONIT
NAME OF INSTITUTION

Emërtimi i kategorisë së biletës / Naming of ticket category

Bileta e vlefshme për / Ticket valid only for

dd / mm / yy

Çmimi i Biletës / xxxx Lekë
Ticket price / xxxx Lek

Ticket number dd / mm / yy hh:mm
Serial number

Logo e UNESCO

Logo e institucionit

MINISTRIA E KULTURËS

8.57 cm

1. Përmasat e biletës manuale 8.57cm x 5.37cm.
2. Bileta përmban logon e Ministrisë së Kulturës dhe logon e institucionit administrues.
3. Logo e UNESCO-s vendoset nëse s'itë ndodhet brenda pasurisë kulturore botërore.
4. Imazhi përfaqësues i institucionit vendoset në pjesën e prapme të biletës.

LIDHJE NR.2

Çmimi i biletës

Nr.	Emërtimi	Çmimi në SPORTEL Bileta Individuale elektronike, manuale / Lekë
1	Muzeu Historik Kombëtar	500
2	Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi, Shkodër	700
3	Muzeu Kombëtar i Përgjimeve " Shtëpia me Gjethe"	700
4	Muzeu Kombëtar Gj. K. Skënderbeu, Krujë	500
5	Muzeu Kombëtar Etnografik, Krujë	400
6	Muzeu Kombëtar Ikonografik "Onufri", Berat	400
6/1	Muzeu Kombëtar Ikonografik "Onufri", Berat, (bileta Audio Guidë)	500
7	Muzeu Kombëtar Etnografik, Berat,	300
8	Muzeu Arkeologjik Durrës	400
9	Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, Korçë	700
10	Muzeu i Arsimit, Korçë	300
11	Muzeu Arkeologjik, Korçë	300
12	Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, Vlorë	300
13	Parku Kombëtar i Butrintit	1000
14	Parku Kombëtar Arkeologjik Apolloni	600
15	Parku Kombëtar Arkeologjik , Kalaja Shkodër	400
16	Parku Kombëtar Arkeologjik , Kalaja Lezhë	300
17	Parku Kombëtar Arkeologjik Bylis	400
18	Parku Kombëtar Arkeologjik, Amantia	300
19	Parku Kombëtar Arkeologjik, Orikum	300
20	Parku Kombëtar Arkeologjik, Finiq	300
21	Parku Kombëtar Arkeologjik, Antigone	300
22	Kalaja Berat	300
23	Kalaja Gjirokastër	400
24	Amfiteatri	300
25	Kalaja e Porto-Palermos	300
26	Kalaja e Kaninës	300
27	Kalaja e Himarës	300
28	Manastiri i 40 Shënjtoreve	200

LIDHJA NR.3

Kategoritë e biletave dhe çmimet e reduktuara

1. Hyjnë pa pagesë në muzetë me status kombëtar, muzetë qendror publik, monumentet e kulturës dhe parqet arkeologjike, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, subjektet e mëposhtëm:
 - a) delegacionet zyrtare shtetërore;
 - b) punonjësit e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucioneve në varësi të kësaj ministrie, të pajisur me dokument identifikimi nga titullari i institucionit;
 - c) individët, të cilët kanë shtëpi banimi, pronë apo biznes, ose të punësuar pranë tyre, brenda kufijve të parkut kombëtar arkeologjik ose monumentit të kulturës, të pajisur me leje përkatëse nga titullari i institucionit, i cili administron parkun kombëtar arkeologjik ose monumentin e kulturës;
 - d) individët që ushtrojnë veprimtari të përkohshme ose të përhershme brenda kufijve të parkut kombëtar arkeologjik ose monumentit të kulturës, të pajisur me leje të vlefshme nga drejtuesi i institucionit që ka në administrim ambientet e institucionit, territorin e parkut kombëtar arkeologjik, ose monumentit të kulturës;
 - e) anëtarët e pajisur me kartat ICOMOS- ICOM;
 - f) studentët e organizuar në ekspedita mësimore dhe leksione të hapura, të pajisur me vërtetim nga entet përkatëse;
 - g) nxënësit e shkollave të arsimit parashkollor, nëntëvjeçar dhe parauniversitar, në kuadër të zhvillimit të orëve mësimore apo programit të "Edukimit përmes Kulturës", me vërtetim nga entet përkatës, si dhe shoqëruesit e tyre;
 - h) veteranët e luftës, që gëzojnë këtë status sipas ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 "*Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar*", i ndryshuar, dhe kanë dëshmi zyrtare identifikimi;
 - i) ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë, sipas ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993 "*Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist*", i ndryshuar, që kanë dëshmi zyrtare identifikimi;
 - j) invalidët paraplegjik dhe tetraplegjik, që gëzojnë këtë status dhe kanë dëshmi zyrtare identifikimi, si dhe personat, që i shoqërojnë ata, sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 "*Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik*", i ndryshuar, dhe kanë dëshmi zyrtare identifikimi;
 - k) fëmijët nën moshën 12 (dymbëdhjetë) vjeç, shoqëruar me dokumentin zyrtar provues;
 - l) individët e licencuar nga ministria përgjegjëse për turizmin si guidë turistike, në momentin e shoqërimit të grupit të turistëve;

m) në të gjitha rastet e tjera kur janë nënshkruar marrëveshje dypalëshe, të miratuara nga ministria përgjegjëse për kulturën, midis institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe palëve të treta në funksion të ruajtjes, mbrojtjes dhe promovimit të pasurisë kulturore.

2. Hyjnë **pa pagesë** vizitorë vendas dhe të huaj në muzetë me status kombëtar, muzetë qendror publike, monumentet e kulturës dhe parqet arkeologjike, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në ditët si më poshtë vijon:

- a) 18 Prill, Dita Ndërkombëtare e Monumenteve/Dita Ndërkombëtare e Trashëgimisë kulturore;
- b) 18 Maj, Dita Ndërkombëtare e Muzeve;
- c) 21 Maj, Dita Ndërkombëtare e Diversitetit Kulturor për Dialog dhe Zhvillim;
- d) 29 Shtator, Ditët Evropiane të Trashëgimisë Kulturore;
- e) 28 Nëntor, Dita e Pavarësisë (vetëm për shtetasit shqiptar);
- f) 29 Nëntor, Dita Kombëtare e Çlirimit (vetëm për shtetasit shqiptar);
- g) e diela e fundit e çdo muaji (vetëm për shtetasit shqiptar);

3. Hyjnë **me çmim të reduktuar** në muzetë me status kombëtar, monumentet e kulturës dhe parqet arkeologjike, subjektet e mëposhtëm:

- a) studentët e pajisur me kartën e studentit, të cilët përfitojnë reduktim në masën 70% të çmimit të biletave, bazuar në urdhrin e përbashkët nr. 418, datë 30.07.2019 të Ministrit të Kulturës dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë *“Për përcaktimin e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit në fushën e artit dhe kulturës”*;
- b) fëmijët nga mosha 12 - 18 vjeç, të pajisur me dokumentin zyrtar provues, të cilët përfitojnë reduktim në masën 70% të çmimit të biletave;
- c) jetimët, që gëzojnë këtë status sipas ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 *“Për statusin e jetimit”* i ndryshuar, si dhe kujdestarët ligjorë të tyre, të pajisur me dëshmi zyrtare identifikimi, të cilët përfitojnë reduktim në masën 50% të çmimit të biletave;
- d) invalidët, që gëzojnë këtë status sipas ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 *“Për statusin e invalidit”* i ndryshuar, si dhe kujdestarët ligjorë të tyre, të pajisur me dëshmi zyrtare identifikimi, të cilët përfitojnë reduktim në masën 50% të çmimit të biletave;
- e) pensionistët, të pajisur me dokumentin zyrtar provues, të cilët përfitojnë reduktim në masën 50 % të çmimit të biletave.
- f) vizitorë vendas dhe të huaj në grupe +12 të cilët përfitojnë reduktim sipas listës më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi	Kategoria Grup
1	Muzeu Historik Kombëtar	400
2	Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi, Shkodër	600
3	Muzeu Kombëtar i Përgjimeve " Shtëpia me Gjethe"	500
4	Muzeu Kombëtar Gj. K. Skënderbeu, Krujë	400
5	Muzeu Kombëtar Etnografik, Krujë	300
6	Muzeu Kombëtar Ikonografik "Onufri", Berat	300
6/1	Muzeu Kombëtar Ikonografik "Onufri", Berat, (bileta Audio Guidë)	400
7	Muzeu Kombëtar Etnografik, Berat,	200
8	Muzeu Arkeologjik Durrës	300
9	Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, Korçë	500
10	Muzeu i Arsimit, Korçë	200
11	Muzeu Arkeologjik, Korçë	200
12	Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, Vlorë	200
13	Parku Kombëtar i Butrintit	800
14	Parku Kombëtar Arkeologjik Apolloni	500
15	Parku Kombëtar Arkeologjik , Kalaja Shkodër	300
16	Parku Kombëtar Arkeologjik , Kalaja Lezhë	200
17	Parku Kombëtar Arkeologjik Bylis	300
18	Parku Kombëtar Arkeologjik, Amantia	200
19	Parku Kombëtar Arkeologjik, Orikum	200
20	Parku Kombëtar Arkeologjik, Finiq	200
21	Parku Kombëtar Arkeologjik, Antigone	200
22	Kalaja Berat	200
23	Kalaja Gjirokastër	300
24	Amfiteatri	200
25	Kalaja e Porto-Palermos	200
26	Kalaja e Kaninës	200
27	Kalaja e Himarës	200
28	Manastiri i 40 Shënjtoreve	100